



Titulli i projektit

Ngritja e qendrës për përpunimin e frutave të stinës

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

Bajram Curri, të gjitha NJQV-të e Zonës Funksionale do të përfitojnë

Buxheti i paravlerësuar

10,000,000 lekë

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Një nga gjetjet kryesore të studimit mbi Zonën Funksionale Tropojë është se fermeret nuk janë të orientuar nga tregu dhe në përgjithësi, prodhimi bujqësor dhe blektoral përdoret për plotësimin e nevojave individuale të familjeve fermere. Një pjesë e vogël e prodhimeve bujqësore dhe blektorale tregtohen në qytetin e Bajram Currit, ose në funksion të turizmit në Luginën e Valbonës. Orientimi dhe mbështetja për fermerët për të dalë në treg, apo për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqësore dhe blektorale ka qenë e pamjaftueshme. Vetëm një pjesë e vogël përpunohet në kushtet e shtëpisë, kryesisht për plotësimin e nevojave familjare dhe më pak për treg. Një ndër rekomandimet e studimit është që duhet të mbështeten përpjekjet për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqësore dhe blektorale. Kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në sigurimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë dhe rrijen e të ardhurave nga shitja e produkteve.

Qëllimi/et specifik të projektit

Rritja e të ardhurave nga prodhimet lokale nëpërmjet përpunimit dhe valorizimit të tyre.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

1. Furnizimi i tregut, sidomos operatorëve turistikë, me produkte lokale bujqësore dhe blektorale të përpunuara është rritur dhe përmirësuar.
2. Të ardhurat lokale janë rritur si pasojë e valorizimit nga përpunimi i frutave dhe produkteve bujqësore dhe të pyllit në përgjithësi.

Nga ky projekt do të përfitonin fermerët e zonës funksionale Tropojë, që do të gjenin një treg të gatshëm për tregtimin e produkteve të tyre dhe do të rrisnin të ardhurat e tyre. Megjithatë qendra do të vendoset në qytetin e Bajram Currit, përfitues do të jenë të gjithë fermerët dhe bizneset e zonës funksionale.



Aktivitetet e projektit

1. Studimi i fizibilitetit.
2. Përgatitja e projektit teknik.
3. Sigurimi i lejeve të nevojshme nga pushteti vendor dhe/ose qendror.
4. Ndërtimi i qendrës.
5. Promovimi i qendrës tek prodhuesit lokale.

Kohëzgjatja e realizimit të projektit është rreth 12 muaj.

Maturimi i projektit

Projekti është në fazën e projekt-idesë. Nuk ka ndonjë projekt teknik të zhvilluar, apo studim fizibiliteti.

Kostoja është e përafërt, e vendosur bazuar në projekte të ngjashme.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e financimit mund të jenë fondet nga qeverisja qendrore (në kuadrin e projekteve në mbështetje të zhvillimit të bujqësisë dhe agro-përpunimit) dhe kreditimi nga bankat. Bashkia do të mbështesë projektin tek financuesit potencialë dhe do të pajisë ndërmarrësin me lejet e nevojshme.

Kostot e projektit

Kostoja totale e përafërt e projektit është 10,000,000 lekë.